



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Datë: 04.02.2025

Grupi Punues për hartimin e Projekt Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Gjakovës, i formuar përmes vendimit numër 01-112/02-16922 nga Kryetari i Komunës, duke u bazuar në nenin 68 paragrafi 3 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 19, nenin 21, nenin 22 paragrafi 2, nenin 27, nenin 28 dhe nenin 29 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) numër 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, me datë 04.02.2025 nxjerr këtë:

KONSULTIM PUBLIK

**PROJEKT RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM,
SISTEMATIZIMIN DHE KLASIFIKIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË
KOMUNËN E GJAKOVËS**

Konsultimi Publik për Projekt Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Gjakovës do të qëndrojë i hapur për 15 ditë, nga data **05.02.2025** deri me datën **19.02.2025**. Drafti i këtij dokumenti do të qëndroj online në ueb faqen zyrtare të komunës së Gjakovës në lidhjen: <https://gjakova.rks-gov.net/draft-dokumentet/>.

Komentet, sugjerimet apo vërejtjet lidhur me dokumentin mund t'i adresoni përmes postës elektronike në adresat: kushtrim.brahimaj@rks-gov.net dhe nita.efendia@rks-gov.net.

Gjithashtu, Komuna e Gjakovës e ka paraparë edhe një takim fizik në kuadër të këtij Konsultimi Publik, i cili do të mbahet me datën **20.02.2025** me fillim prej orës 10:00 ne Sallën e Kuvendit te Komunës së Gjakovës (në objektin e ish – Bankosit).